



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1919/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI144/21

Parashtrues

Emin Cakiqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktakuzës PP. II. nr. 5422/19 të
Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të 17 nëntorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Emin Cakiqi, me vendbanim në Drenas (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktakuzën [PP. II. nr. 5422/19] e 17 nëntorit 2020 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktakuzës së Prokurorisë Themelore për të cilën pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit]; 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]; dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 10 gusht 2021, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilën e kishte dërguar me postë.
6. Më 19 gusht 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
7. Më 9 shtator 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i kërkoj që: (i) të plotësojë formularin e kërkesës; (ii) të saktësojë aktin apo vendimin konkret të autoritetit publik të cilin e konteston para Gjykatës; (iii) të saktësojë se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar përmes aktit të cilin ai e konteston; dhe (iv) në kuadër të saktësimit të vendimit të kontestuar të autoritetit publik, po ashtu të dorëzojë dokumentet relevante mbështetëse të kërkesës, përfshirë edhe ankesat eventuale në lidhje me vendimin e kontestuar.
8. Më 23 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë: (i) formularin e plotësuar të kërkesës; (ii) specifikoi se konteston Aktakuzën [PP. II. nr. 5422/19] të 17 nëntorit 2020, të Prokurorisë Themelore; (iii) saktësoi të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur përmes aktakuzës së lartcekur të Prokurorisë Themelore; dhe (iv) dorëzoi kopjen e aktakuzës së kontestuar të Prokurorisë Themelore, si dhe dokumente të tjera.

9. Më 25 tetor 2021, Gjykata i dërgoi Prokurorisë Themelore njoftimin për regjistrimin e kërkesës, si dhe i kërkoi që ta njoftojë Gjykatën se në cilën fazë të procedurës është lënda përkitazi me aktakuzën e lartcekur të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 29 tetor 2021, Prokuroria Themelore njoftoi Gjykatën se procedura penale është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Dega në Glllogoc. Në mbështetjeje të kësaj informate, Prokuroria Themelore njoftoi se në këtë gjykatë janë mbajtur 5 (pesë) seanca të shqyrtimit fillestar dhe se seanca për shqyrtimin e dytë gjyqësor është paraparë që të mbahet më 22 nëntor 2021.
11. Më 25 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 1 korrik 2019, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Glllogocit, nxori Aktvendim [08-nr. 360/01-37008] përmes të cilit kërkohet që parashtruesi i kërkesës të lirojë banesën, e evidentuar si pronë e kësaj komune.

Procedura administrative

13. Në një datë të pasaktësuar, kundër Aktvendimit të Komunës së Glllogocit, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: Ministria).
14. Më 23 korrik 2019, Ministria nxori Vendim [A-160/18] përmes të cilit konstatoi se nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës.
15. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, kishte parashtruar kërkesëpadi për anulimin e Vendimit [A-160/18], të 23 korrikut 2019 të Ministrisë.
16. Më 24 nëntor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 1423/19]: (i) aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi Vendimin e MMPH-së; dhe (iii) obligoi Ministrinë që të veprojë “sipas pikëpamjeve juridike dhe vërejtjeve të dhëna lidhur me procedurën nga ana e kësaj gjykate”.
17. Gjykata Themelore konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje që ndërlidhen me uzurpim të pronës dhe se juridiksion për të vendosur në këtë çështje ka Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe rrjedhimisht Ministria lëndën në lidhje me këtë çështje duhet ta përcjellë për shqyrtim të kjo agjenci.

18. Më 6 janar 2021, Agjencia Kadastrale e Kosovës, pas përcjelljes së lëndës nga Ministria, u përgjigj se kompetencë lëndore për vendosjen apo regjistrimin e pronësisë është organi komunal kadastral në Gllogoc.
19. Më 8 janar 2021, Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi i Komunës së Gllogocit ndaj kërkesës së parashtruesit të kërkesës për regjistrim të pronës, të 23 dhjetorit 2020 u përgjigj se për regjistrimin e banesës, të cilin ai pohon se është në pronësi të tij, ky i fundit duhet që të dorëzojë aktin juridik i cili dëshmon që ai është pronar i kësaj banese.

Kërkesa e parashtruesit në Institucionin e Avokatit të Popullit

20. Më 3 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, përmes të cilës kishte pohuar shkelje të të drejtave dhe lirive të tij nga ana e autoriteteve publike. Si rezultat i kësaj kërkesë, më 10 dhjetor 2020, Institucioni i Avokatit të Popullit përmes njoftimit për pranueshmëri e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ka pranuar kërkesën e tij dhe e ka regjistruar në regjistrin e saj dhe do të vazhdojë me hetimin e shkeljeve eventuale të pohuara nga ai.

Procedura e kontestuar penale

21. Më 17 nëntor 2020, Prokuroria Themelore në Prishtinë, ngriti Aktakuzën [PP II. nr. 5422/19] kundër parashtruesit të kërkesës dhe 6 (gjashtë) të pandehurve tjerë nën dyshimin se kanë kryer veprën penale "Uzurpimi i paligjshëm i pronës se paluajtshme" nga neni 320, paragrafi 1 i Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK). Sipas kësaj aktakuze, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike akuzohej se duke filluar nga viti 2010 në vazhdimësi dhe në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar banesën, pronë e paluajtshme në emër të Komunës së Drenasit, dhe të njëjtën vazhdon ta shfrytëzojë edhe pas nxjerrjes së Vendimit të kësaj komune [08-nr. 360/01-37008] të 1 korrikut 2019 për lirim të banesës.
22. Më 11 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore kishte parashtruar kundërshtim kundër aktakuzës së ngritur ndaj tij.
23. Bazuar në informatat e dorëzuara nga Prokuroria Themelore, rezulton që pas ngritjes së aktakuzës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Dega në Gllogoc (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) më 11 dhjetor 2020, 14 qershor 2021, 6 korrik 2021 dhe 17 shtator 2021 janë mbajtur seanca të shqyrtimit fillestar, dhe se seanca për shqyrtimin e dytë gjyqësor është paraparë që të mbahet më 22 nëntor 2021. Në mbështetje të kësaj të fundit, Prokuroria dorëzoi procesverbalin e Gjykatës Themelore, të 26 tetorit 2021, përmes të cilës seanca e shqyrtimit të dytë gjyqësor ishte caktuar që të shtyhet dhe vendosur që e njëjta të mbahet më 22 nëntor 2021. Sipas këtij procesverbali, të 26 tetorit 2021, rezulton që i pranishëm në këtë seancë ishte edhe parashtruesi i kërkesës.
24. Sipas dokumentacionit të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës, po ashtu rezulton që ky i fundit kundër prokurores, e cila kishte ngritur aktakuzën e kontestuar kishte iniciuar procedurë disiplinore.

25. Më 8 mars dhe 28 korrik 2021, respektivisht, Prokuroria Themelore përmes shkresës [AD. nr. 04/21] e njoftoi parashtruesin e kërkesës *“pretendimet nga ana e juaj nuk kanë paraqitur bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj prokurores së rastit dhe se aktakuza është ngritur duke u bazuar në prova dhe pas vërtetimit të dyshimit të bazuar mirë”*.
26. Në fund, Prokuroria Themelore theksoi se *“[...] pas përfundimit të fazës së ngritjes së aktakuzës dhe deklaramit, fillon faza III-të, respektivisht faza e shqyrtimit gjyqësor, ku gjyqtari drejton shqyrtimin gjyqësor, kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes në pajtim me administrimin e provave. Po ashtu, gjykata do të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar. Pra e ripërsërisim edhe njëherë se tanimë mbetet në diskrecionin dhe bindjen e lirë të gjykatës për të vlerësuar epilogun përfundimtar të kësaj çështjeje”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktakuza e Prokurorisë Themelore i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
28. Në kërkesën e tij, të plotësuar dhe të dorëzuar në Gjykatë më 23 shtator 2021, parashtruesi i kërkesës thekson se i janë shkelur të drejtat e *“[tij] për të pasur mbrojtës dhe për të paraqitur mbrojtjen pasi që asnjëherë nuk jam thirrur nga prokurori apo nga gjykata për të deklaruar rreth kësaj veprë”*.
29. Parashtruesi i kërkesës specifikon se *“banesa është e imja. E njëjta më është ndarë nga BVI e banimit të Komunës së Drenasit, pasi që kam banuar aty e që për këtë e di më së miri drejtori [I.N.], por që dokumentacioni më është djegur bashkë me shtëpi gjatë luftës”*.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata *“[...] dëshiroj të realizojë të drejtën time për të pasur mbrojtës dhe për t’u mbrojtur nga aktakuza dhe të konstatohet se njëjta është ngritur duke u shkelur të drejtat e mia kushtetuese dhe ligjore”*.

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24

[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike,

sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 30 **[Të Drejtat e të Akuzuarit]**

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;

(2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;

(3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

(4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;

(5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;

(6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Neni 31 **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatare, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale të Kosovës

Neni 240

Gjykimi penal që zbatohet vetëm pas ngritjes së aktakuzës

1. Pas përfundimit të hetimit ose kur Prokurori i Shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit.

[...]

Neni 242 **Procedura për ngritjen e aktakuzës**

1. Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga Prokurori i Shtetit.

2. Gjykata cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin e tij nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, ashtu siç duhet.

Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, njëri nga gjyqtarët e kolegjit caktohet si gjyqtar i vetëm gjykues ose si kryetar i trupit gjykues ose si anëtar i trupit gjykues.

3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën.

4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës.

5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës.

6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

Neni 250

Kërkesa për hedhjen e aktakuzës

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:

1.1. vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;

1.2. ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;

1.3. ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose

1.4. nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

[...]

Neni 254

Shqyrtimi i dytë dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor

1. Në shqyrtimin e dytë marrin pjesë Prokurori i Shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë.

2. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet që mbrojtësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave nga neni 256 i këtij Kodi.

3. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shqyrton kundërshtimet nga neni 249 ose kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.

Ai mund të kërkojë nga Prokurori i Shtetit që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit ose me shkrim, në pajtim me nenet 249- 253 të këtij Kodi.

4. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton seanca dëgjimore në pajtim me nenin 255 të këtij Kodi, nëse seancat e tilla janë të nevojshme.

5. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr

aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.

6. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjidhura pas shqyrtimit të dytë. Ai cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

33. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49 [Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

34. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39, pikës (1) (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e Pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar; [...]

35. Fillimisht, Gjykata rikujton se objekt i vlerësimit të kërkesës së parashtruesit të kërkesës është Aktakuza e [PP. II. nr. 5422/19] e Prokurorisë Themelore, e 17 nëntorit 2020. Të gjitha procedurat e ndjekura që ndërlidhen me regjistrimin dhe vërtetimin e pronësisë së banesës, e të reflektuara në pjesën e përmbledhjes së fakteve të këtij aktvendimi nuk përbëjnë objekt vlerësimi të kësaj kërkesë, pasi që këto shprehimisht nuk janë kontestuar nga parashtruesi i kërkesës.
36. Prandaj, për sa i përket përmbushjes së kërkesave të lartcekura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktakuzën [PP. II. nr. 5422/19] të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të 17 nëntorit 2020.
37. Rrjedhimisht, bazuar në faktin se akti i kontestuar nga ana e parashtruesit të kërkesës është Aktakuza e [PP. II. nr. 5422/19] e 17 nëntorit 2020 e ngritur ndaj tij me dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale “uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 320, paragrafi 1 i KPRK-së, Gjykata, në vijim do të shqyrtojë plotësimin e kriterit të shterimit të mjeteve juridike.
38. Në lidhje me aktin e kontestuar, përkatësisht Aktakuzën e Prokurorisë Themelore, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë specifike pretendon se atij i është shkelur e drejta “për të pasur mbrojtës” dhe se në lidhje me aktakuzën e ngritur, nuk është “thirrur nga prokurori apo nga gjykata për të deklaruar rreth kësaj vepre”.
39. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk e kishte njoftuar Gjykatën në lidhje me procedurën e zhvilluar pas ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore. Në lidhje me këtë, Prokuroria Themelore në përgjigjen e saj ndaj kërkesës për informata të dërguar nga Gjykata, e kishte njoftuar këtë të fundit se procedura penale është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Dega në Glllogoc. Në mbështetje të kësaj informate, Prokuroria Themelore po ashtu e njoftoi Gjykatën se në këtë gjykatë gjatë vitit 2020 dhe 2021, përkatësisht

më 11 dhjetor 2020, 14 qershor 2021; 6 korrik 2021 dhe 17 shtator 2021 janë mbajtur seancat e shqyrtimit fillestar dhe se seanca për shqyrtimin e dytë gjyqësor është paraparë që të mbahet më 22 nëntor 2021. Në lidhje me këtë të fundit, Prokuroria Themelore dorëzoi edhe procesverbalin [P. nr. 332/2020] e shqyrtimit të dytë të Gjykatës Themelore, të 26 tetorit 2021, në të cilin seancë ishte vendosur që seanca të shtyhej për datën 22 nëntor 2021. Sipas këtij procesverbali, të 26 tetorit 2021, rezulton që i pranishëm në këtë seancë ishte edhe parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, Gjykata vëren se kundër aktakuzës së kontestuar, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kundërshtim në Gjykatën Themelore.

40. Në vijim të elaborimit të lartcekur, Gjykata duke iu referuar dispozitave ligjore, përkatësisht dispozitave të procedurës penale vëren se në bazë të nenit 240 të Kodit 04/L-123 të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK), procedura e ngritjes së aktakuzës fillon pas përfundimit të hetimeve. Rrjedhimisht, neni 242 i KPPRK-së përcakton që aktakuza e ngritur nga Prokuroria i dorëzohet gjykatës kompetente e cila cakton mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e ngritjes së aktakuzës nga ana e Prokurorisë. Në vijim, në bazë të nenit 250 të KPPRK-së përcaktohet që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe para shqyrtimit të dytë, të pandehurit kanë të drejtë të iniciojnë procedurën e hedhjes së aktakuzës. Në bazë të dispozitave të KPPRK-së, përkatësisht nenit 254, pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave për hedhje të aktakuzës, dhe në rastin kur kundërshtimet dhe ankesat e të pandehurve përkitazi me hedhje të aktakuzës janë refuzuar, fillon procedura e shqyrtimit gjyqësor.
41. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Gjykata vëren se procedura penale është në fazën e shqyrtimit të dytë para Gjykatës Themelore. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, përfshirë edhe të drejtën e tij për të pasur mbrojtës, ashtu siç garantohet me nenin 30 të Kushtetutës, mund t'i paraqes edhe në procedurën penale, e cila është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore. Prandaj, përderisa çështja në lidhje me aktakuzën e kontestuar të Prokurorisë është në procedurë të shqyrtimit dhe përderisa parashtruesi i kërkesës ka akoma mjete juridike në dispozicion për të ngritur shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë para gjykatave të rregullta, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të vlerësojë dhe ofrojë konstatimin e saj në lidhje me shkeljet e pretenduara.
42. Gjykata në vazhdimësi e respekton parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta, me qëllim që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të korrigjojnë shkeljen e tillë të një të drejte themelore të garantuar me Kushtetutë.
43. Siç ka theksuar Gjykata në vazhdimësi përmes praktikës së saj gjyqësore, qëllimi dhe arsyetimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit, është t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E Drejta për

Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe në nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, kërkesa nr. 25803/94, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 74; dhe ndër të tjera, shih edhe rastin e Gjykatës KI135/17, me parashtrues *Borce Petrovski*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafët 62-66 dhe referencat e përdorura aty).

44. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e parakohshme dhe duhet të refuzohet si e papranueshme bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenin 49 të Ligjit si dhe në rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 49 të Ligjit dhe me rregullat 39 (1) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 nëntor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani